



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ANILA Q. KAÇUPI
ADRESA NR.10, RESHIT COLLAKU,
AURORA, NR.1, NR.8
TEL: 676049924

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 4313

Nr. koleksioni: 3212

Tirane më 30/09/2025

Anila
Kacupi

Firmosur elektronikisht nga
NISA me certifikaten :Anila
Kacupi
Data: 2025.09.30
13:07:05+02:00

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2025052940349053968

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2025052940349053968

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

Sot, më datë 30.09.2025., para meje Notere ANILA Q. KAÇUPI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.10, RESHIT COLLAKU, AURORA, NR.1, NR.8, u paraqit personalisht:

SHITES: Ardian Dushaj, atësia Sulejman, amësia Tule, shtetas Shqiptar, lindur në Koplik, Shkodër dhe banues në Malësi E Madhe, me adresë Dobër; Nd. 084; Qendër; Dobër; 4301; Malësi E Madhe, lindur më 23/06/1971, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036208748 dhe nr. personal H10623149R, në cilësinë e ortakut, zotërues i 30% të kuotave të Shoqërisë "REPORTAGE ALBANIA" shpk, me NUIS M41305004P, me adresë: Tiranë, Rr. "Elbasanit", "Lion Residence Building", kati i parë, Tiranë.

BLERES: Shoqëria FELIX ALBANIA, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M51607056R, me adresë Tirane, Njesia Administrative Nr.2, Rruga E Elbasanit, Lion Residence, Kati 1., përfaqësuar nga Administratori Klodian Kamenica, atësia Pandi, amësia Vasiliqi, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në DURRËS, me adresë Aleksander Goga 00690045; Nd. 46; H. 1; Durrës; Durrës; 2003; Durrës, lindur më 18/06/1976, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038090879 dhe nr. personal H60618060C.

Palët pasi kanë rënë dakord midis tyre, në zbatim të neneve 705 e vijues të Kodit Civil, Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, dhe hartojnë këtë kontratë për shitjen e kuotave sipas kushteve dhe përcaktimeve të mëposhtme:

BAZA LIGJORE

1. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 e vijues.
2. Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.

Të dhëna paraprake:

Shoqëria "Reportage Albania" shpk është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar me datë 26.12.2023 dhe regjistruar pranë QKB me datë 05.01.2024. Kapitali themeltar i kësaj shoqërie është 1.038.700,00 Lekë dhe është i ndarë në 2 kuota. Ortakët e kësaj shoqërie zotërojnë respektivisht: Felix Albania shpk 70 % të kuotave dhe Ardian Dushaj 30 % të kuotave.

Palët bien dakord si më poshtë vijon:

NENI 1

OBJEKTI I KONTRATËS

- 1.1 Objekt i kësaj kontrate është shitja e kuotës në zotërim të ortakut Ardian Dushaj që përfaqëson 30 % të kapitalit themeltar të shoqërisë "Reportage Albania" shpk në favor të blerësit shoqërisë "Felix Albania" shpk.

NENI 2

TRANSFERIMI DHE SHITJA

- 2.1 Kuotat në zotërim të ortakut Ardian Dushaj, 1 kuote në masën 30% me vlerë 311,610 leke do të shiten Shoqërisë Felix Albania.
- 2.2 Ardian Dushaj ka arketuar vlerën 360,000 euro (treqind e gjashtëdhjetë mijë euro) e cila konsiston në vlerën e investimit nga ortaku për shoqërinë. Shoqëria Reportage Albania nepermjet kësaj kontrate do të kalojë Ortakut Ardian Dushaj vlerën prej 360,000 euro (treqind e gjashtëdhjetë mijë euro).
- 2.3 Kuotat e shitura janë të lira nga çdo barrë apo kufizim.



A2025052940349053968

NENI 3**DEKLARIMET DHE GARANCITË E SHITËSIT**

- 3.1 Shitësi pranon se deklarimet në këtë kontratë shitje janë të vërteta, të plota dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate:
- a. Shitësi garanton blerësin se ai është i vetmi zotërues i ligjshëm i kuotave që shet në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe ka të drejtën e shitjes të këtyre kuotave.
 - b. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj kontrate nga shitësi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, statutin, kontratat, marrëveshjet apo akte të tjera ligjore, subjekt i të cilave është shitësi.
 - c. Çdo deklarim apo garanci e dhënë nga shitësi sipas kësaj kontrate është i vërtetë.

NENI 4**DEKLARIMET E BLERËSIT**

- 4.1 Blerësi pranon se deklarimet e mëposhtme janë të vërteta, të plota dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate.
- a. Blerësi ka tagra të plota për të pranuar pjesët e kapitalit nga shitësi sipas përcaktimeve të kësaj kontrate.
 - b. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj kontrate nga shitësi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është blerësi.

NENI 5**TRANSFERIMI I TË DREJTAVE MBI PJESËMARRJEN**

- 5.1 Pronësia mbi kuotën/pjesën e kapitalit të shoqërisë, objekt i kësaj kontrate, kalon nga shitesi tek blerësi menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate. Kalimi i pronësisë së kuotave të shoqërisë në favor të blerësit do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me Ligjin Nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" I ndryshuar, dhe Ligji Nr. 9723/2007 "Për Qendrën Kombëtare të biznesit" I ndryshuar.
- 5.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitesi humbet çdo të drejtë mbi 30% të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë, që transferohen nëpërmjet kësaj kontrate, përfshirë të drejtën e ushtrimit të votës në mbledhjet e Asamblesë dhe ndarjes së fitimeve që rrjedhin nga zotërimi i tyre. Të gjitha të drejtat që burojnë nga zotërimi i 30 % të kapitalit të shoqërisë të shitur sipas kësaj kontrate, i transferohen blerësit dhe ky i fundit bëhet titullar i ligjshëm i pjesëmarrjes që përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë "Reportage Albania" shpk.
- 5.3 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, blerësi gëzon të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi pjesëmarrjen prej 100% të kuotave të zotëruara, në emër të tij në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe pranë çdo institucioni tjetër shtetëror sipas legjislacionit në fuqi.
- 5.4. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë Z.Klodian Kamenica, i datëlindjes 18.06.1976, lindur në Durrës dhe banues në Dubai, Sun Tower, floor 59 unit 05, AL Reem Island, Abu Dhabi, Emiratet e Bashkuara, identifikuar me anë të letërnjoftimit ID me Nr. 038090879 dhe Nr. personal H60618060C, për të bërë regjistrimin e Kontratës së Shitjes së Kuotave dhe të gjitha akteve të tjera bashkëlidhur kësaj Kontrate, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe në Regjistrin e Pronarëve Përfitues.
- 5.5 Me lidhjen e kësaj kontrate shitesi largohet nga shoqëria, ndërsa blerësi bëhet ortak me 100 % të kapitalit të shoqërisë "Reportage Albania".

NENI 6**ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

- 6.1 Kjo kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me Ligjin Nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe çdo dispozite tjetër rregulluese sipas legjislacionit shqiptar të aplikueshëm.
- 6.2 Në rast se midis palëve do të lindin mosmarrëveshje në të ardhmen, palët do të përpiqen ti zgjidhin ato me mirëkuptim, në rast mos arritje të një zgjidhje me mirëkuptim, atëherë palët do të drejtohen gjykatës, dhe kompetente do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.



A2025052940349053968

Kjo kontratë shitje kuotash hartohet në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje origjinale.

Kjo kontratë i'u lexohet palëve me zë të lartë e të qartë nga unë noteri dhe pasi u gjet e rregullt dhe në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u nënshkrua rregullisht prej palëve në praninë time, dhe unë noteri e vërtetoj atë sipas ligjit dhe për të gjitha efektet e saj.


PALËT

SHITES: Ardian Dushaj

në cilësinë e ortakut zotërues i 30% të kuotave të
Shoqërisë "REPORTAGE ALBANIA" shpk

BLERES: Shoqëria "FELIX ALBANIA" shpk

përfaqësuar nga Administratori Klodian Kamenica



Noter
ANILA Q. KAÇUPI

Nr. Prot.

VENDIMI ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË “REPORTAGE ALBANIA” SHPK

DATE 30.09.2025

Sot, në Tiranë, më datë 30.09.2025, në mbështetje të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, i ndryshuar, Aktit të Themelimit si dhe Statutit të shoqërisë “Reportage Albania” Shpk, është mbledhur Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë “Reportage Albania” shpk, pas thirrjes së administratorit të shoqërisë Z.Klodian Kamenica me kërkesë të ortakut të shoqërisë Felix Albania shpk.

Kjo mbledhje realizohet në selinë qendrore të shoqërisë, me adresë: Rruga e “Elbasanit”, “Lion Residence Building”, kati i parë, Tiranë, me rend dite si më poshtë:

- *Lejimin e shitjes të 30 % të kuotave të ortakut Ardian Dushaj nga shoqëria “Reportage Albania” shpk tek shoqëria “Felix Albania” shpk.*
- *Autorizimin e administratorit të shoqërisë “Reportage Albania” shpk të kryejë të gjitha procedurat e nevojshme për regjistrimin e këtyre ndryshimeve në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në Regjistrin e Pronarëve Përfitues si dhe në të gjithë institucionet e Administratës Publike të Republikës së Shqipërisë.*

Në këtë mbledhje marrin pjesë Ortakët në pjesë përkatëse të kapitalit themeltar të shoqërisë “Reportage Albania” shpk, Felix Albania shpk i cili zotëron 70% të kapitalit themeltar të shoqërisë të perbere nga Z. Giovanni Emanuele Nucera me 50% të kapitalit dhe Simona Musso me 50% të kapitalit, dhe **Z.Ardian Dushaj** 30% të kapitalit themeltar, të cilët pasi u njohën me rendin e ditës dhe biseduan atë në tërësi, në cilësinë e asamblesë së përgjithshme vendosën në unanimitet si më poshtë:


1. *Lejimin e shitjes të kuotave prej 30 % të kapitalit themeltar të shoqërisë “Reportage Albania” shpk në zotërim të ortakut Ardian Dushaj, në favor të shoqërisë “Felix Albania” shpk me NUIS M51607056R.*
2. *Reflektimin e këtyre ndryshimeve në Qendrën Kombëtare të Biznesit.*
3. *Autorizimin e administratorit të shoqërisë “Reportage Albania” shpk të kryejë të gjitha procedurat e nevojshme për regjistrimin e këtyre ndryshimeve në Qendrën Kombëtare*

të Biznesit, në Regjistrin e Pronarëve Përfutues si dhe në të gjithë institucionet e Administratës Publike të Republikës së Shqipërisë.

Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë "Reportage Albania" shpk

ORTAKËT:

Felix Albania shpk



"FELIX ALBANIA" SHPK
NUIB : M51607056R
TIRANË - ALBANIA

Z.Ardian Dushaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

**EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E
SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"**

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	M51607056R
2. Data e Regjistrimit	07/04/2025
3. Emri i Subjektit	FELIX ALBANIA
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	15/02/2025
6. Kohëzgjatja	Nga: 15/02/2025
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane Tirane, Njesia Administrative nr.2, Rruga e Elbasanit, Lion Residence, kati 1.
8. Kapitali	10.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	100,00
9. Objekti i aktivitetit	Blerje, shitje, transferim, mbajtje aksionesh: - Shitblerje, ndertim pasurish te paluajtshme
10. Administratori/ët	Klodian Kamenica
10.1 Afati i emërimit	Nga: 15/02/2025 Deri: 15/02/2030
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore	
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)	
12. Ortakët	FELIX HOLDING
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100.000,00 Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00
12.4 Komente (nëse ka)	
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	E-Mail: tradelicense@reportageuae.com Telefon: 00971506342544



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

15. Statusi:	Aktiv
--------------	-------

Datë: 30/09/2025





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

**EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E
SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"**

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	M41305004P
2. Data e Regjistrimit	05/01/2024
3. Emri i Subjektit	REPORTAGE ALBANIA
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	26/12/2023
6. Kohëzgjatja	Nga: 26/12/2023
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane Rruga e Elbasanit, Lion Residence Building, kati i pare, Tirane
8. Kapitali	1.038.700,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	Investime ne Shoqeri pasurish te paluajtshme. Zhvillim Institucional, menaxhim, ndertime civile, investime. Mundet gjithashtu te kryeje te gjitha operacionet tregtare, financiare, mobiliare e imobiliare qe eventualisht konsiderohen te nevojshme dhe oportune per te arritur ose nxitur permbushjen e objektit social. Prodhimi dhe tregtimi i materialeve te ndertimit. Pjesemarrja permes blerjes se aksioneve ose formave te tjera direkte ose indirekte ne shoqeri te tjera. Ndertim i objekteve te banimit, civile dhe industriale duke perfshire te gjitha fushat ne sektorin e ndertimit.
10. Administratori/ët	Klodian Kamenica
10.1 Afati i emërimit	Nga: 26/12/2023 Deri: 26/12/2028
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore	
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)	
12. Ortakët	Ardian Dushaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

12.1 Vlera e kapitalit	Para: 311.610,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	30,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Ortakët	FELIX ALBANIA	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 727.090,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	70,00	
13.4 Komente (nëse ka)		
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: REPORTAGE ALBANIA E-Mail: klodian@dimenionuae.com Telefon: 00971569234333	
16. Statusi:	Aktiv	

Datë: 30/09/2025

Nr. Prot.

VENDIM I
ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË “FELIX HOLDING” SHPK

DATA 30.09.2025

Sot, në Tiranë..., më datë 30.09.2025, në mbështetje të Statutit të shoqërisë “Felix Holding” Shpk, Aktit të Themelimit si dhe të Ligjit....., mbledhet Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë “Felix Holding” shpk, pas thirrjes së administratorit të shoqërisë Z.Amir M Deb Shikh Dabas me kërkesë të ortakut të shoqërisë Z. Giovanni Emanuele Nucera.

Në këtë mbledhje marrin pjesë Ortakët e shoqërisë “Felix Holding” shpk,

- **Z. Giovanni Emanuele Nucera**, i cili zotëron 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë,
- **Znj.Simona Musso**, e cila zotëron 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, si dhe;
- **Z. Amir M Deb Shikh Dabas**, administrator i shoqërisë.

Mbledhja realizohet në selinë qendrore të shoqërisë me adresë në: Tamouh Tower, 28th Floort, Marina Square, Al Reem Island, Abu Dhabi, EBA, me rend dite si më poshtë:

- *Lejimin e pranimi të shitjes se 30% të kuotave në zotërim të shtetasit Ardian Dushaj pranë shoqërisë shoqëria “Reportage Albania” shpk në favor të shoqërisë “Felix Albania” shpk.*
- *Autorizimin e administratorit të shoqërisë “Felix Albania” shpk të nënshkruajë kontratën e dhurimit të kuotave në favor të shoqërisë “Felix Albania” shpk.*

Asambleja e Përgjithshme pasi u njohën me rendin e ditës dhe diskutuan atë në tërësi, vendosën në unanimitet si më poshtë:


1. *Lejimin e pranimi të shitjes të 30% të kuotave në zotërim të shtetasit Ardian Dushaj pranë shoqërisë shoqëria “Reportage Albania” shpk në shoqërinë “Felix Albania” shpk me NUIS M51607056R.*

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë “Felix Holding” shpk

ORTAKËT:


Z.Giovanni Emanuele Nucera




Znj.Simona Musso

Administratori:

Amir M Deb Shikh Dabas



No. Prot.

**DECISION OF
GENERAL ASSEMBLY OF THE "FELIX HOLDING" LLC COMPANY**

DATED: 30.09.2025

Today, in ~~the~~....., on 30.09.2025, in support of the Statute of the "Felix Holding" LLC company, the Deed of Establishment as well as Law no., the General Assembly of the "Felix Holding" LLC Company is convened, following the call of the company administrator, Mr. Amir M Deb Shikh Dabas, at the request of the company partner Mr. Giovanni Emanuele Nucera.

This meeting is attended by the Partners of the company "Felix Holding" LLC,

- **Mr. Giovanni Emanuele Nucera**, who owns 50% of the company's share capital,
- **Mrs. Simona Musso**, who owns 50% of the company's share capital, as well as;
- **Mr. Amir M Deb Shikh Dabas**, company administrator.

The meeting takes place in the company's headquarters with address at:, with the following agenda:

- *Allowing the acceptance of the sale of 30% of the quotas held by citizen Ardian Dushaj in the "Reportage Albania" LLC company, in favor of the "Felix Albania" LLC company.*
- *Authorization of the administrator of the "Felix Albania" LLC company to sign the contract for the donation of quotas in favor of the "Felix Albania" LLC company.*

The General Assembly, after reviewing the agenda and discussing it in its entirety, unanimously decided as follows:

1. *Allowing the acceptance of the sale of 30% of the quotas held by citizen Ardian Dushaj in the "Reportage Albania" LLC Company, to the "Felix Albania" LLC company with TIN M51607056R.*

General Assembly of the "Felix Holding" LLC Company

PARTNERS:

Mr. Giovanni Emanuele Nucera


Mrs. Simona Musso

Administrator:

Amir M Deb Shikh Dabas



